

VENDIM
Nr. 912, datë 19.12.2012

PËR AUTORIZIMIN E “EKSSI” SHPK, PËR IMPORTIN E MBETJEVE TË PLASTIKËS PËR QËLLIME RICIKLIMI

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të pikës 3 të nenit 22 të ligjit nr. 8934, datë 5.9.2002 “Për mbrojtjen e mjedisit”, të ndryshuar, dhe të pikës 2 të nenit 49 të ligjit nr. 10 463, datë 22.9.2011 “Për menaxhimin e integruar të mbetjeve”, me propozimin e Ministrit të Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit të Ujërave, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Autorizimin e “EKSSI” sh.p.k., për importin e mbetjeve të plastikës me kode doganore:
- GH 010 3915 -- mbetje, prerje dhe kthime prej plastike;
- GH 011 ex 3915 10 -- prej polimereve të etilenit;
- GH 012 ex 3915 20 -- prej polimereve të stirenit;
- GH 013 ex 3915 30 -- prej polimereve të vinil kloridit;
- GH 014 ex 3915 90 -- prej plastikave të tjera (polimere ose bashkime polimeresh);
dhe kodin B3-B3010 të Konventës së Bazelit, aneksi 1 “Mbetjet e listës së gjelbër”, referuar vendimit nr. 550, datë 22.8.2012 të Këshillit të Ministrave “Për disa ndryshime në vendimin nr. 825, datë 13.10.2010 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e listave të mbetjeve që lejohen të importohen për qëllime përdorimi, riciklimi dhe përpunimi”.

2. Sasia e mbetjeve të plastikës që do të importohet, sipas kodeve të referuara në pikën 1 të këtij vendimi, është 4 500 (katër mijë e pesëqind) tonë në vit.

3. Mbetjet do të importohen nga shtetet e Maqedonisë, Kosovës, Malit të Zi, Serbisë dhe vendet e Bashkimit Europian. Transporti do të bëhet në rrugë tokësore dhe detare, pasi të plotësohet i gjithë dokumentacioni i nevojshëm ligjor për transportin ndërkombëtar të mbetjeve, si dhe kërkesat e kreut II të vendimit nr. 806, datë 4.12.2003 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e rregullave dhe procedurave për importimin e mbetjeve për qëllime përdorimi, përpunimi dhe riciklimi”. Ambalazhimi i tyre të bëhet në paleta i presuar ose në thasë plastikë në përputhje me përcaktimin e bërë në aneksin 3, bashkëlidhur vendimit nr. 825, datë 13.10.2010 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e listave të mbetjeve që lejohen të importohen për qëllime përdorimi, riciklimi dhe përpunimi”, të ndryshuar.

Për çdo transfertë ndërkufitare të mbetjeve “EKSSI” sh.p.k. dorëzon të plotësuar në Ministrinë e Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit të Ujërave dokumentin e lëvizjes/transfertës ndërkufitare të mbetjeve, sipas formatit të dhënë në aneksin IV bashkëlidhur vendimit nr. 550, datë 22.8.2012 të Këshillit të Ministrave, dhe monitorimi i tyre të kryhet nga strukturat përkatëse të doganave. Çdo transfertë mbetjesh duhet të jetë e pajisur me raport-analizë, të kryer për aspektin e radioaktivitetit.

4. Periudha e lejimit të importit të mbetjeve të plastikës nga “EKSSI” sh.p.k., është 1- vjeçare (njëvjeçare) nga data e hyrjes në fuqi të këtij vendimi.

5. Ministria e Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit të Ujërave, në zbatim të kërkesave ligjore të sipërpërmendura dhe për të siguruar mbrojtjen e mjedisit e të shëndetit publik, merr masat e nevojshme për kontrollin e procesit të riciklimit të mbetjeve të plastikës nga “EKSSI” sh.p.k., pas hyrjes në fuqi të këtij vendimi.

6. Ministria e Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit të Ujërave komunikon me shkrim me shtetet eksportuese dhe ato, ku do të bëhet kalimi transitor i mbetjeve, për autorizimet përkatëse në bazë të të cilave do të lejohet kalimi i kësaj sasive të mbetjeve të plastikës, në përmbushje të kërkesave të Konventës së Bazelit “Për kontrollin e lëvizjeve ndërkufitare të mbetjeve të rrezikshme dhe asgjësimin e tyre”, konventë në të cilën Republika e Shqipërisë është palë.

7. Ngarkohen Ministria e Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit të Ujërave dhe Drejtoria e Përgjithshme e Doganave për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha